

KONTRATË SHITBLERJE (KUOTA Kapitali)

Sot më datë 01.11.2022 (dymijë e njëzetë e dy), në përputhje me Kodin Civil, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" nenet 105 e vijues te tij, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe statutit të shoqërisë "ALTEC" sh.p.k me kushtet e mëposhtme:

I PALËT

Pala Shitëse :

ARBEN ALIAJ, i dtl. 18.03.1970, lindur ne Mallakaster dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Leternjoftimi ID: H00318168P, ne cilesine e ortakut me 100,00% te kuotes te "ALTEC" sh.p.k, fakt i provuar nepermjet ekstraktit te publikuar ne web-site zyrtar te QKB per kete shoqeri ne momentin e hartimit te kontrates.

Pala Blerëse:

ALEKSANDER ALIAJ, i dtl. 09.06.1973, lindur ne Mallakaster dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Leternjoftimi ID: H30609121I.

Kushtet Paraprake

Shoqëria "ALTEC" sh.p.k, është themeluar dhe regjistruar si person juridik pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), me Certifikatë Regjistrimit (NIPT) K57923807W, me seli në "Mallakaster", Njesia Administrative "Fratar", Fshati "Ninesh", Rruga "Qender", Godina Nr.15, "Mallakaster", me kapital të regjistruar 8.200.000,00 (tetëmilion e dyqindmijë) lekë, dhe përfaqësues ligjor Z.Arben Aliaj.

- Ortaku i vetem aktual i shoqërisë, zotërues te 100% te kuotave të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë "ALTEC" sh.p.k, ka kryer bisedime paraprake me blerësin e kuotave, duke respektuar radhen e parablerjes se kuotave si dhe duke saktësuar të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë dhe duke e njohur paraprakisht blerësin me të gjithë dokumentacionin e shoqërisë fakt për të cilin blerësi konfirmon dijeninë e tij rregullisht.
- Palet pasi kanë bërë në mënyrë individuale, vlerësimin e shoqërisë duke u bazuar në; pasqyrat financiare të publikuara deri në fund të vitit 2021; në gjendjen aktuale të aktivitetit të saj; si dhe në parashikimin e të ardhmes së natyrës së biznesit të shoqërisë për një periudhë afatmesme, lidhur me perspektivën e sektorit në të cilin ajo operon, kanë arritur në konkluzionin, se:
 - a) Shoqëria deri në fund të vitit 2021, rezulton me kapitalin e nenshkruar, ne vlerën prej 8.200.000,00 (tetëmilion e dyqindmijë) lekë.
 - b) Ortaku aktual i shoqërisë Z.Arben Aliaj, ka vendosur të shesë nje pjese te kuotave te zoteruara prej tij ne masen prej 51,00% te kuotave totale prej 100,00 % tyre qe zoteron te shoqërisë "ALTEC" sh.p.k.
 - c) Per shkak te lidhjes se posacme te paleve te cilet jane vellezer me njeri-tjetrin, te drejtat dhe detyrimet respektive për perfitimin dhe pagesën në të ardhmen të dividendëve te pa shperndara apo te krijuar ne te ardhmen, do të transferohen në të drejtat që do të blejë blerësi i kuotave me shitjen totale të këtyre kuotave dhe shitesi heq dore ne menyre te parevokueshme nga cdo lloj pretendimi ne lidhje me kete percaktim.

- d) Me vendimin datë 01.11.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur me kuorumin e 100 % të kuotave në prani të ortakut të vetëm të saj është vendosur miratimi për shitjen e 51,00% të kuotave përkatëse që ortakut Z.Arben Aliaj zotëron në shoqërinë "ALTEC" sh.p.k, kuota keto në favor të blerësit Z.Aleksander Aliaj, duke e shderruar kete te fundit pas kesaj shite ne ortak te ri te shoqërisë së bashku me ortakun aktual.

II OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate shitësi **Z.Arben Aliaj**, i shet palës blerëse **Z.Aleksander Aliaj**, një pjesë të kuotave të zotëruara prej tij në masën prej **51,00% të kuotave totale prej 100,00 %** të tyre që zotëron në shoqërisë "ALTEC" sh.p.k, ose 1 pjesë të kuotave të saj, pra të gjithë pjesën prej 51,00% të kuotave totale të shoqërisë, të cilat shitësi i zotëron në kapitalin e regjistruar të shoqërisë "ALTEC" sh.p.k, dhe janë të vlerësuar me vlerën e tyre nominale në shumën prej 4.182.000 leke.

III CMIMI

3.1 Palët shitësi **Z.Arben Aliaj**, dhe blerësi **Z.Aleksander Aliaj** kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së 51,00 % të kuotave të totalit të shoqërisë, kuota keto që pala shitëse i shet palës blerëse Z.Aleksander Aliaj të jetë **51.000 leke** (pesëdhjetë e një mijë) lekë.

3.2 Palët deklarojnë se çmimi i kuotave objekt i kësaj kontrate është likujduar nga pala blerëse në mënyrë individuale tek pala shitëse, që në vitin 2006, që me krijimin e shoqërisë dhe me konceptin e përbashkët për ndërtimin dhe menaxhimin e saj, duke pranuar nga palët me vullnetin e tyre të plotë mungesën e çdo lloji pretendimi për pagesën e cmimit të shitjes së kuotave.

IV KALIMI I PRONËSISË

4.1 Pronësia mbi 51,00 % të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ALTEC" sh.p.k e shitesit, do të kalojë përfundimisht nga shitësi, tek pala blerëse pas dorezimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje autentike nga të cilat një kopje duhet të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), një kopje duhet të depozitohet në selinë e shoqërisë dhe nga një kopje e marrin palët shitëse dhe blerësi.

Konsiderohen pjesë e kontratës dhe do të bashkëngjiten asaj për efekt të regjistrimit aktet si më poshtë:

- Vendimi i asamblese së përgjithshme të shoqërisë i datës 01.11.2022 që miraton kalimin e kuotave nga pala shitëse tek pala blerëse.
- Kopjet e dokumentave të identifikimit të paleve shitëse dhe blerëse.

Kjo kontratë pasi u lexua me zë të lartë në prani të palëve dhe u kuptua prej tyre, dhe u gjet në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua rregullisht prej tyre.

PALA SHITËSE

ARBEN ALIAJ

PALA BLERËSE

ALEKSANDER ALIAJ